ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Dogana e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**201 13300-24-8294-2-1-1**
Nr i brendshëm	**201.133.24.044.211**

Sa i përket tenderit për: "Shërbimet për asgjësimin e cigareve, produkteve te duhanit dhe mallrave tjera sipas nevojave të DK-së".

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

MetBat SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gllogoc, Malet e Krivoves
(Adresa)

Gllogoc — ***13 000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+38344124280 — ***N/A***
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Nardi Kadriu
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nardimetbat@gmail.com
(Adresa elektronike)

24.02.2025
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

MetBat SH.P.K. — NËNSHKRIM ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 17.09.2024 Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 11.11.2024 Njoftimi mbi Vendimin e AK-se i dt. 17.12.2024 Njoftimi mbi dhënien e kontratës i dt. 26.12.2024 Njoftimi për anulimin e dhënies së kontratës i dt. 06.02.2025 Kërkesa për rishqyrtim dt.10.02.2025 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:18.02.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** ☐

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 9 i LPP-së** **Neni 26 i LPP-së** **Neni 62 i LPP-së** **Neni 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik** **Neni 45 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik** **Neni 8 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ju sqarojmë se njoftimi për kontratë ishte bërë me dt. 17.09.2024, ndërsa hapja e ofertave ishte bërë me dt.11.11.2024 ku kishin marr pjesë tre operator ekonomik. Njoftimi mbi vendimin ishte publikuar me dt. 17.12.2024 ku ne ishim rekomanduar për kontratë. Në lidhje me këtë njoftim nuk kishte pasur kërkesë për rishqyrtim e as ankesë. Publikimi i njoftimit për dhënie të kontratës ishte bërë me dt. 26.12.2024, e ku ishte planifikuar nënshkrimi i kontratë për **dt.30.12.2024.**

Me dt.09.01.2025 kemi pranuar një shkresë për pezullim të nënshkrimit të kontratës me tekstin si më poshtë:

"Të nderuar,

"Ju njoftojmë se pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës për: ''Shërbimet për asgjësimin e cigareve, produkteve te duhanit dhe mallrave tjera sipas nevojave të DK-së", me nr.pr. 201 13300-24-8294-2-1-1 procesi i nënshkrimit të kontratës është pezulluar deri në vlerësimin e situatës se pranueshmerise se juaj si OE në raport me Doganën e Kosovës.

Për çdo informatë shtesë dhe veprim të mëtutjeshëm do t'iu mbajmë të njoftuar".

Me dt.07.02.2024 kemi pranuar vendimi për anulim të dhënies së kontratës me arsyetimin si më poshtë:
Tek Rubrika V.2) informacionet shtesë është shënuar si në vijim:

> *Shto informacione tjera:*
> **3. Baza ligjore dhe arsyet për anulim Autoriteti Kontraktues pas dhënies se kontratës për aktivitetin e prokurimit ''Shërbimet për asgjësimin e cigareve, produkteve te duhanit dhe mallrave tjera sipas nevojave të DK-së'', ka vendosur qe të anulojë dhënien e kontratës për arsye se Pas shqyrtimit të kërkesave buxhetore në janar të vitit 2025, del se këtë vit kemi shumë më pak mjete të ndara për buxhetin e Doganës sesa viti paraprak. Dhe konkretisht të ky projekt, mjetet e planifikuara për vitet në vijim nuk arrijnë realizimin e kontratës sipas vlerës se parashikuar dhe përqindjes se kategorive. Dhe një shumë e caktuar e mjeteve buxhetore të 2025 duhet të kalon për obligimet qe ka AK nga porositë e mallrave në vitin 2024 (uniforma), të cilat nuk arritur të realizohen deri në fund të vitit 2024. Përveç kësaj, Autoriteti Kontraktues për asgjësim te cigareve dhe duhanit është duke shqyrtuar edhe mundësi tjera të asgjësimit djegies. Sqarim Derisa klikimi të fusha Një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit është përdorur pika Një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, vetëm për qëllime teknike të përgatitjes se këtij njoftimi për anulim te dhënies se kontratës pasi qe nuk kemi urdhër të lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, por anulimi i dhënies se kontratës bëhet me kërkesë të AK.**

Nga arsyetimi i lartpërmendur shihet që AK-së ka ndërmarr veprime kundërligjore kur ka potencuar se një shumë e caktuar e mjeteve buxhetore duhet të kalon për porositë e mallrave -uniforma. Kjo kontratë është kontratë kornizë 36 muaj dhe nuk duhet të jenë mjetet e siguruar qysh në start sepse kjo kontratë ka të bëjë me çmime për njësi, prandaj ky arsyetim është absurd. Mjetet për uniforma e të tjera janë në kategori të veçanta dhe nuk duhet ngatërruar me këtë projekt. Tek kontrata kornize mjetet ndahen për secilin vit, prandaj edhe hipotetikisht po të mos të kishte mjete këtë vit apo të kishte më pak atëherë në vitin tjetër pasues mund të zotohen mjetet dhe të vazhdohet me kontratë, pasi që kjo kontratë është kornizë për 36 muaj.
Edhe arsyetimi se janë duke shikuar mundësi të tjera të djegies është arsyetim i paqëndrueshëm dhe absurd përderisa ka qenë i publikuar ky tender dhe është arritur në këtë fazë.

Se kanë ekzistuar tendencat ndaj kompanisë tonë, e tregon fakti se me dt.30.12.2023 është planifikuar nënshkrimi i kontratës ndërsa rreth një muaj më vonë bëhet anulimi i dhënies së kontratës, pra me dt.07.02.2024.

Pra është pritur një muaj që të nxjerrët njoftimi për anulim të dhënies së kontratës, e që nënkuptohet se është përgatitur dhe punuar në këtë drejtim rreth një muaj për të gjetur ndonjë arsyetim për të mos nënshkruar kontratë me kompaninë tonë.

Tendenca e AK-së kuptohet edhe më qartë me veprimin e dt.19.01.2025 kur është pezulluar procesi i nënshkrimit të kontratës. Ky veprim tregon se autoriteti kontraktues është munduar të gjejë ndonjë arsye për të anuluar këtë projekt dhe të na dëmtojë neve.
Përderisa është nënshkruar fillimisht deklarata e nevojave dhe përcaktueshmërisë së fondeve dhe përderisa është bërë publikimi i njoftimit për dhënie të kontratës nuk ka qenë kontestuese çështja e mjeteve financiare, prandaj arsyeja e anulimit është kundërligjore.

Në këtë rast janë shkelur dispozitat e nenit 26 të LPP-së dhe 42.4 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim publik.
42.4 Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58), Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj atë brenda 30 ditëve kalendarike. AK-së nuk ka respektuar këtë dispozitë.
Në këtë rast nuk është respektuar neni 26 i LPP-së nga AK-së edhe pse janë përmbushur të gjitha kushtet për nënshkrim të kontratës.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerr me dt.18.02.2025, ku arsyetimi është dhënë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues në shqyrtim te këtyre pretendimeve ankimore te OE konstaton se vlerësimi i këtij tenderi është bërë bazuar në rregullat e LPP dhe kushtet e përcaktuara në dosjen e tenderit. Mirëpo pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës B08 Njoftim për dhënie të kontratës - 27.12.2024, Autoriteti Kontraktues në rrethana tjera ka vendosur qe të anulojë dhënien e kontratës për arsye se:
Pas shqyrtimit të kërkesave buxhetore në janar të vitit 2025, del se këtë vit kemi shumë më pak mjete të ndara për buxhetin e Doganës sesa viti paraprak. Dhe konkretisht të ky projekt, mjetet e planifikuara për vitet në vijim nuk arrijnë realizimin e kontratës sipas vlerës se parashikuar dhe përqindjes se kategorive. Dhe një shumë e caktuar e mjeteve buxhetore të 2025 duhet të kalon për obligimet qe ka AK nga porositë e mallrave në vitin 2024 (uniforma), të cilat nuk arritur të realizohen deri në fund të vitit 2024.
Përveç kësaj, Autoriteti Kontraktues për asgjësim te cigareve dhe duhanit është duke shqyrtuar edhe mundësi tjera të asgjësimit/djegies.
Sqarim: Derisa klikimi të fusha Një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit është përdorur pika: Një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, vetëm për qëllime teknike të përgatitjes se këtij njoftimi për anulim te dhënies se kontratës pasi qe nuk kemi urdhër të lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, por anulimi i dhënies se kontratës bëhet me kërkesë të AK.

Qëndron fakti se Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar edhe pranueshmerinë e OE në raport me Doganën e Kosovës në rastin konkret lidhur me një aktvendim nga Sektori i Kontrolles Pasimpurtuese për obligime doganore. Edhe pse ky fakt nuk ka qenë arsye e anulimit të dhënies se kontratës.
Prandaj, anulim i dhënies se kontratës është bërë sipas arsyetimin të lartcekur.

Edhe ky arsyetim nuk është i mbështetur në dispozita të LPP-së e as në argumente tjera me ndonjë dëshmi eventuale.
Sa i përket mjeteve që cekën për këtë vit e që kinse kanë më pak mjete, ky fakt nuk përbën ndonjë arsye ligjore pasi që ky projekt ka qenë i planifikuar nga vetë AK-së dhe atë për 36 muaj, prandaj nuk ka asnjë rëndësi se sa mjete janë këtë vit apo vitin tjetër, pasi që mjetet që kanë qenë të destinuara për këtë projekt duhet të shfrytëzohen edhe tani e jo të përdoret kjo arsye për anulim të këtij tenderi, pasi që janë kaluar të gjitha fazat e procedurës së prokurimit deri tek nënshkrimi i kontratës. LPP nuk parasheh që një procedurë e prokurimit të anulohet para nënshkrimit të kontratës prandaj AK-së ka vepruar kundërligjshëm.

Sa i përket mjeteve të tjera që duhet të kalojnë për një projekt tjetër për uniforma, sqarojmë se projektet janë të ndara dhe po ashtu buxheti për projekte është i ndarë veçantë, prandaj ky arsyetim nuk ka asnjë bazë ligjore e faktike.
Arsyetimi tjetër se është duke u shqyrtuar ndonjë mundësi tjetër të asgjësimit djegies, është më të vërtetë absurd sepse mundësitë thera është dashur të shikohen para shpalljes së këtij tenderi e jo para nënshkrimit të kontratës, prandaj nga ky arsyetim kuptohet tendenca që me çdo kusht ne mos lejohemi të nënshkruajmë kontratën.
Ky veprim i AK-së është arbitrarizëm i plotë dhe tregon që AK-së ka autonomi të nxjerrjes së vendimeve për anulim në secilën fazë që dëshirojnë, mirëpo këto veprime nuk kanë mbështetje ligjore prandaj edhe OSHP duhet të luaj rolin e saj ku duhet ta detyrojë AK-së që të nënshkruaj kontratën pasi që kanë kaluara të gjitha fazat dhe hapat procedural të këtij aktiviteti të prokurimit.
Veprimi i AK-së për anulim të këtij tenderi bie ndesh me nenin 97.1 pika K e Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, ku shkruan qartë që shkelje e rëndë konsiderohet edhe : "

Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Duke pasur parasysh këtë shkelje të rëndë të AK-së kërkojmë nga OSHP-ja që të kërkojë nga KRPP që të revokohet licenca ZPP sipas nenit 99.1 të RRPP dhe njëkohësisht ti shqiptohet gjobë AK-së sipas nenit 131 të LPP-së.

Duke pasur parasysh faktet e lartcekura rezulton se neve jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe po dëmtohemi materialisht. AK-ja ka rënë në kundërshtim me veprimet e saj që i kishte bërë sipas nenit 59 të LPP-së, pra që kishte bërë vlerësimin e ofertave, e ku ishte nënshkruar raporti i vlerësimit prej anëtarëve të komisionit dhe nga zyrtari përgjegjës i prokurimit. Nuk ka asnjë dispozitë ligjore që AK-ja ka mundur të thirret për të anuluar njoftimin për dhënie të kontratës dhe për më tepër veprimi i saj nuk është në harmoni me konsistencën që e ka pasur që nga fillimi i aktivitetit të prokurimit deri më tani, kurse tani ka vepruar në kundërshtim të plotë me të gjitha veprimet e mëparshme. Duke pasur parasysh këto fakte, rezulton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për nënshkrim të kësaj kontrate dhe se veprimi i AK-së është i kundërligjshëm.

Anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenit 43.5 dhe 43.7 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk po nënshkruani kontratën, kurse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa në këtë rast është vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë.
Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

I. **APROVOHET,** e bazuar ankesa e OE **MetBat SH.P.K..**

II. **ANULOHET, njoftimi për anulim të dhënies së kontratës (formulari B11) dhe të vazhdohet me procedura të nënshkrimit të kontratës sipas nenit 26 të LPP-së.**

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, si dhe fitimi i humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*